



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

**Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i
Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade**

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
Jedinica za upravljanje ljudskim resursima / Human Resources Management Unit

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në pajtim me nenin 48 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, dhe paragrafin 6, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe duke u bazuar në nenin 23 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 dhe paragrafin 3 dhe 4 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, më datë 10.10.2024 publikon këtë:

SHPALLJE PUBLIKE

***Për pranimin e aplikimeve për një (1) ekspert i jashtëm për anëtarë të Komisionit të Pranimit
për kategorinë e lartë drejtuese***

1. Kandidatët për ekspert i jashtëm të Komisionit të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, në pajtim me dispozitat e nën paragrafit 2.3 paragrafit 2 të nenit 23 të Rregullores (QRK) nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:

- të kenë diplomë universitare të paktën 240 kredi, kurse për diplomat e marra jashtë vendit, nevojitet nostrifikimi;
- të kenë tetë (8) vite përvojë pune profesionale prej të cilave të paktën pesë (5) vite në pozita të nivelit drejtues;
- të mos kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
- të kenë integritet moral dhe profesional;
- të mos kenë aktakuzë të konfirmuar dhe të mos kenë qenë të dënuar për kryerjen e një vepre penale jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- të mos jetë i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

2. Për kandidatët për ekspert i jashtëm të Pranimit për kategorinë e lartëdrejtuese, duhet të dorëzohen dokumentet në vijim:

- Biografinë (CV-në);
- Dëshminë e kualifikimit profesional (diplomën e fakultetit). Për diplomat e pranuar
- jashtë vendit duhet të bashkëngjitet nostrifikimi i diplomës;

- Dëshmitë për përvojën profesionale dhe përvojën menaxheriale në pozitat e nivelit drejtues;
- Deklaratën me shkrim që nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
- Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga gjykata kompetente jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Deklaratën me shkrim që nuk është i punësuar në shërbimin civil, që nuk është i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe që nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- Kopjen e letërnjoftimit ose të pasaportës (me afat të vlefshëm me rastin e aplikimit).

Kandidatët për ekspert i jashtëm për kategorinë e lartë drejtuese si personalitet i pavarur në Komisionin e Pranimi për kategorinë e lartë drejtuese, përfiton një pagesë fikse prej dyqind e pesëdhjetë (250.00) Euro për procedurë të rekrutimit, në pajtim me dispozitat e nenit 23 paragrafit 4 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurat e Pranimi në Shërbimin Civil.

Afati për dorëzimin e CV-së, dhe dokumenteve përcjellëse sipas pikës 1 dhe 2 të kësaj thirrje publike për anëtar të Komisionit të Pranimi për kategorinë e lartë drejtuese, është i hapur nga 11/10/2024 deri më datë 18/10/2024.

Për të gjithë të interesuarit ofrohen mundësi të barabarta.

Kandidatët e interesuar për aplikim për ekspert i jashtëm për anëtarë të Komisionit të Pranimi për kategorinë e lartë drejtuese dokumentet e bashkëngjitura mund t'i dërgojnë përmes postës elektronike në e-mail adresën: besa.rama@rks-gov.net ; nexhmije.shala@rks-gov.net

Për informata shtesë mund të kontaktoni në nr. tel: 038/200-36-578 ose në email adresën: besa.rama@rks-gov.net ; nexhmije.shala@rks-gov.net

Ju faleminderit!